



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 104/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga: Agon Ramadani- Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare dhe Vedat Poterqoi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (OE) "Hasan Alija B.I", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme" me nr. të prokurimit: 632-23-327-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, me datën 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet, si e pa-bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Hasan Alija B.I", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 20. 02. 2023 (me numër protokolli 104/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme" me nr. të prokurimit: 632-23-327-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, ndërsa **mbetet në fuqi**, Njoftimi për kontratë i AK për këtë aktivitet prokurimi.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

III. Me qenë se ankesa e Operatorit Ekonomik "Hasan Alija B.I", refuzohet si e pa-bazuar, bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 31.01.2023, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme” me nr. të prokurimit: 632-23-327-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës. Me datën 21. 02. 2023, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara.

OE “Hasan Alija” B.I me datën 15. 02. 2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 20. 02. 2023, AK- KK Gjakovë me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Hasan Alija” B.I, me datën 21. 02. 2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 104/23, kundër njoftimit për kontratë të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 16. 03. 2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pabazuar
- të mbetet në fuqi vendimi për kontratë i AK-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka parashtruar ankese ne OSHP, kundër njoftimit për kontrate të datës: 31.01.2023 - Lot 23 - transporti i nxënësve në relacionin Molliq - Batush dhe anasjelltas, konkretisht OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues nuk e ka parashikuar sakte vlerën e kontratës, sipas nenit 17 të LPP-se dhe lidhur me këtë pretendim ka dhënë një

sqarim/llogaritje të çmimit ku deklaron se nuk mund të realizohet kontrata me këtë vlerë të parashikuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues gjatë fazës së kriterëve ka kërkuar sqarim nga autoriteti kontaktues të cilëve ju ka prezantuar llogarinë se sipas OE ankues me këtë vlerë të parashikuar nuk mund të realizohet projekti në fjalë, ndërsa AK i ka kthyer përgjigje poashtu duke kthyer kalkuluar distancën dhe shpenzimet relevante se si ka ardhur deri tek vlera e parashikuar.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në shkresat e lëndës vlerëson se Autoriteti kontraktues ka vepruar me dispozitat e nenit 18 të LPP-se, për faktin se edhe në përgjigjen e dhënë për OE ankues i ka shpjeguar të gjitha elementet duke përfshirë kilometrat dhe njëherit i ka sqaruar të gjitha distancat e përfshira dhe linjat për secilën shkolle, lidhur me transportin e nxënësve.

- Konstatimet e Panelit shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, vlerëson se mbështetet në raportin e ekspertizës i cili rekomandon mbetjen në fuqi të vendimit të AK-së, andaj arsyetimet e tij llogariten si arsye të PSH.

Ankesa në fjalë si objekt kontestues shqyrtimi ka pasur pretendimin e vetëm se vlera e parashikuar është shumë e ulët, si dhe OE ankues në këtë rast nuk mund të ofertojë duke u bazuar në këtë vlerë të parashikuar, në raport me shpenzimet dhe llogaritjen e tij, lidhur me këtë, OE ankues ka kërkuar sqarime nga AK të cilët janë përgjigjur duke dhënë llogaritjet e tyre se si kanë ardhur deri tek kjo vlerë.

Fillimisht vlen të theksohet se në pretendimet ankimore në të cilat OE ankues ju është referuar aktivitetit paraprak apo kontratës që ata kanë ekzekutuar, PSH konsideron se nuk përbën relevancë në aspektin krahasues për faktin se fillimisht vlen të theksohet se sa i përket vlerës së parashikuar, kërkesat në kriteret e të gjitha këto çështje përcaktohen bazuar nga kërkesat dhe nevojat e AK-së duke konsideruar qëllimin e kontratës, andaj PSH konstaton se pretendimet me të cilat OE ankues ka krahasuar me aktivitete të tjera të mëparshme nuk kanë përbërë relevancë në vendim-marrje për faktin se AK edhe në rastin konkret ka sqaruar se kemi të bëjmë me kërkesa të ndryshuara, gjë që është e kuptueshme duke pasur parasysh që AK konform nevojave të veta, kërkesave dhe qëllimit të kontratës përpilon DT dhe kërkesat në të, andaj krahasimi me aktivitetet e tjera në këtë aspekt sipas PSH është i paqëndrueshëm.

Lidhur me përcaktimin e vlerës së parashikuar, dispozitat përkatëse rregulluese, konkretisht edhe Rregullorja Nr.001/22 për prokurimin publik, në nenin 13, paragrafi 1 saktësohet se: *“Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante*

teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim.”, andaj përveç që mbetet në përgjegjësinë e AK-së që të përcaktojë vlerën e përafërt të kontratës konform shërbimeve të kërkuara, PSH konstaton se AK me sqarimet e dhëna ka shtjelluar kostot e parashikuara e poashtu ka sqaruar se kemi të bëjmë me ndryshime kundrejt kontratës paraprake që e kanë pasur, andaj përfundimisht poashtu duke pasur parasysh tiparet themelore të LPP-së, që janë kursimi i bugjetit të shtetit, ekonomiciteti, efikasiteti, PSH ka konstatuar se OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar argumente, fakte, arsyetim bindës që tregon se kemi të bëjmë me DT të përpiluar jo-saktë, andaj duke u bazuar nga të gjitha se çka u thanë si më sipër, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK Gjakovë

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.